



Aplikim për vizë me qëllim tërheqjen e bashkëshortit/es ose partnerit /es

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuar në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht 8 deri në 12 javë, në raste të veçanta edhe më gjatë. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj për faktin që brenda 8 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Përpara se të aplikoni për vizë për tërheqjen e bashkëshortit/es lutemi të mbani në konsideratë udhëzimet e mëposhtme.

Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:		
1.	Formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, në dy kopje, të plotësuar në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht.
2.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	Fotografi pashaporte	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.
Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, <u>me 2 fotokopje</u> , në momentin e aplikimit		
4.	Pashaporta e udhëtimit	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.

5.	Çertifikatë martesë ose çertifikatë e bashkëjetesës së regjistruar në rast se partnerët janë të të njëjtës gjini	Originali i certifikatës së martesës <u>ose</u> i bashkëjetesës së regjistruar. Certifikatat që nuk janë hartuar në gjuhën gjermane dhe nuk lëshohen sipas një formulari ndërkombëtar duhet të përkthehen dhe të pajisen me vulën apostille. Përkthimi duhet të jetë i noterizuar. Certifikatat shqiptare me formular ndërkombëtar NUK kanë nevojë të përkthehen, por duhet të pajisen me vulën apostille.
6.	Pashaportë / kartë identiteti / leje qëndrimi e bashkëshortit/es ose e partnerit/es	Nëse bashkëshorti / partneri nuk ka nënshtetësinë gjermane, atëherë duhet të paraqiten si pashaporta e udhëtimit ashtu edhe leja e qëndrimit. (Këtu mjafton të paraqisni 2 kopje)
7.	Dëshmi për vendbanimin nga Gjermania	Vërtetim vendbanimi (jo më i hershëm se 6 muaj)
8.	Dëshmi për njohuritë e gjuhës gjermane	Njohuri të thjeshta mbi gjuhën gjermane mund të dëshmohen parimisht nga një certifikatë gjuhe në nivelin „Deutsch – A1“. Informacione më të hollësishme për këtë mund të gjeni në fletën e informacionit „Dëshmi e njohurive të gjermanishtes në procesin e aplikimit për vizë“.
9.	Vërtetim të ardhurash të mjaftueshme për jetesën në Gjermani për aplikuesin/en dhe bashkëshortin/en	Vërtetimet zyrtare të pagës për 3 muajt e fundit Udhëzim: Paraqitja e këtyre vërtetimeve nuk është e nevojshme në rast se bashkëshorti/ja është gjerman/e
10.	Vërtetim për hapësirë të mjaftueshme banimi	Kontratë qeraje e bashkëshortit/es që jeton në Gjermani Udhëzim: Paraqitja e kontratës nuk është e nevojshme në rast se bashkëshorti/ja është gjerman/e

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen dokumenta të caktuar të papërmendura më sipër.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.